

KONTRATE - THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" TOTO-VRION " SH.P.K.



Personat që firmosin më poshtë:

Z. JANI TOTO, I BIRI I JORGJIT, I DATËLINDJES 1951, LINDUR DHE BANUES NË FSHATIN VRION TË RRETHIT DELVINË, ME SHTETËSI SHQIPTARE.

Z. MIHAL TOTO, I BIRI I JORGJIT, I DATËLINDJES 1954, LINDUR DHE BANUES NË FSHATIN VRION TË RRETHIT DELVINË, ME SHTETËSI SHQIPTARE.

Kanc hartuar më poshtë vijon kontraten e themelimit të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën janë marrë vesh ta themelojnë midis tyre.

Shoqeria vepron në baze të dispozitave ligjore në fuqi si dhe të dispozitave të statutit që i bashkëngjitet këtij akti.

Emërtimi i shoqerise është " TOTO - VRION " SH.P.K.

Objekti i shoqerise është: Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë, bujqësorë, blektorale, ushqimorë, karburante dhe lubrifikante, makina, makineri si dhe pjesë këmbimi për to, materiale ndertimi, import-eksport të gjithë artikujve, transport mallrash dhe karburantesh për llogari të shoqerisë dhe të tretëve, servis automjetesh, lavazho.

Selia e shoqerise gjendet në fshatin Vrion të rrethit Delvinë, por me kalimin e kohës selia e shoqerisë mund të ndryshojë si brenda ashtu edhe jashtë rrethit me pëlgimin e ortakëve.

Kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 lekë. Ky kapital përbhet nga kontributet e mëposhtme:

Z. JANI TOTO KONTRIBON ME SHUMËN PREJ 50.000 LEKË.

Z. MIHAL TOTO KONTRIBON ME SHUMËN PREJ 50.000 LEKË.

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 pjesë, plotësishtë të shlyeshme, me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në numrin e serisë 100.

Në bazë të kontributave të mësipërme:

Z. JANI TOTO, merr 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditur sipas numrit të serieve nga 1 deri në numrin e serieve 50, për kontributin e tij në para;

Z. MIHAL TOTO, merr 50 pjesë të kapitalit themeltar, të renditur sipas numrit të serieve nga 51 deri në numrin e serieve 100 për kontributin e tij në para;

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar, shlyer plotësishtë dhe janë shpërndarë ndermjet ortakëve si më lartë.

Shuma e mësipërme është mbledhur nga Z. JANI TOTO dhe është depozituar në Degën e Bankës së shtetit Sarandë, në një llogari të hapur në emr të shoqerisë në formim e sipër.

Shoqeria do të administrohet nga një administrator i vetëm. Administrator i parë i emëruar është z. JANI TOTO, me një mandat 2-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje.


Z. JANI TOTO i jepen të gjitha kopetencat të cilat ai i përdor për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Administratori është i ngarkuar të kryejë akte dhe për të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e shoqerisë dhe kopetencat e tij. Pasi të behet regjistrimi i shoqerisë këto akte i nënshtronen miratimit të bashkësisë së ortakëve jo më vonë se nga data e mbledhjes së Asamblesë që shqyrton dhe vendos për llogaritë e vitit të parë finanziar. Ky miratim bën automatikishtë kalimin e këtyre akteve dhe angazhimeve në ngarkim të shoqerisë.

Kjo kontratë përpilohet në katër ekzemplarë, në Sarandë, me datën 01/09/1995 në gjuhën shqipe duke pasur të gjitha fuqi të barabartë ligjore. Një kopje dorëzohet në Gjykatën e rrethit Tiranë ku behet edhe regjistrimi i shoqerisë, kopja tjetër lihet në zyrën notariale, kopja e tretë dorëzohet në degën e tatime-taksave dhe kopja e katërt mbahet nga vëto ortakët e shoqerisë.

ORTAKËT

JANI TOTO



MIHAL TOTO



S T A T U T
I SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
"TOTO-VRION"SH.P.K.



Personat që firmosin më poshtë:

Z. JANI TOTO, I BIRI I JORGJIT, I DATËLINDJES 1951, LINDUR DHE BANUES NË FSHATIN VRION TË RRETHIT DELVINË, ME SHTETËSI SHQIPTARE.

Z. MIHAL TOTO, I BIRI I JORGJIT, I DATËLINDJES 1954, LINDUR DHE BANUES NË FHSATIN VRION DELVINË, ME SHTETËSI SHQIPTARE.

Kanë hartuar si më poshtë vijon statutin e një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar të cilën janë marrë vesh ta themelojnë midis tyre.

KREU I
FORMA, EMERTIMI I SHOQERISË, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA.

Neni 1

Forma

ndermjet firmuesve të aktit ~~shoqerisë~~ të kufizuar njoë shoqeri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi si dhe me dispozitat e këtij statuti.

Neni 2

Emërtimi i shoqerisë

Emërtimi i shoqerisë është " TOTO - VRION " SH. P. K.

Neni 3

Objekti i shoqerisë

Objekti i shoqerisë është: Tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrialë, bujqësorë, blektorale, ushqimorë, karburante dhe lubrifikante, makina, makineri si dhe pjesë këmbimi për to, materiale ndertimi, import-eksp ort të të gjithë artikujve, transport mallrash dhe karburantesh për llogari të shoqerisë dhe të tretëve, servis automjetesh, lavazho.

Tan

duhai

Neni 4

Selia e shoqerisë

Selia e shoqerisë ndodhet në fshatin Vrion të rrethit Delvinë. Transferimi i shoqerisë në një adresë tjetër behet me miratim të dy ortakëve.

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqerisë është parashikuar për një periudhë prej 20 vjetësh duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Kjo periudhë mund të zgjatet tej këtij afati ose të shkurtohet kur shoqeria prishet para kohe.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR.

Neni 6

Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar është 100.000 lekë.

Ai është i ndarë në 100 pjesë të barabarta me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në 100 të shlyera plotësishtë. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nepërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësise në nënshkrim proporcionalishtë me shumën e pjesëve të tyre. Shoqeria mund të zvogëlojë kapitalin e saj. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asamblea e ortakëve me prezencën e vet ortakëve që me miratimin e tyre. Zvogëlimi i kapitalit i prek të dy ortakët në të njëjtën masë.

Neni 7

Kontributet

Z. JANİ TOTO	, kontribon me shumën prej 50.000 lekë.
Z. MIHAL TOTO	, kontribon me shumën prej 50.000 lekë.

Neni 8

Pjesët e kapitalit themeltar.

Në bazë të kontributeve të lartëpërmendura:

Z. JANİ TOTO , merr 50 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 50, për kontributin e bij në para.

Z., MIHAL TOTO, merr 50 pjesë të kapitalit themeltar, të renditur nga numri i serisë 51 deri në numrin e serisë 100, për kontributin e tij në para.

Të gjitha pjesët e kapitalit htemeltar nënshkruhen, shlyhen plotësishtë dhe shpërndahen ndermjet ortakëve sipas ndarjes së mësipërme.

Neni 9

Lenia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirishtë të transferueshme ndermjet ortakëve në rrugë trashëgimie në rast ndarjeje paurore ndermjet bashkëshortëve, ndermjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen të tretëve vetëm me pëlgimin e të dy ortakëve dhe me kushte jo më të favorshme se ato me të cilat u janë afruar ortakëve të tjera më parë.

KREU III

ORTAKËT, ASAMBLEA E ORTAKËVE, ADMINISTRIMI, EKSPERTËT KONTABEL.

Neni 10

Ortakët dhe Asamblea e ortakëve.

Ortakët e shoqerisë përballojnë humbjet e saja deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Në ushtrimin e së drejtës së tyre për të marrë pjesë në vendimet kolektive çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga seicili ortak, nga administratori, nga ekspertët kontabël të autorizuar ose nga likujduesi. Sipas rendesës së vendimeve mbledhja e Asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Asamblea e zakonshme vendos përrëfeshtje të tillë si: emërimi dhe shkrimi i administratorëve, ekspertëve kontabëll, të autprizuar dhe likujduesve, miratim të raporteve të administrimit, kontrollit, miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit.

Asamblea e jashtëzakonshme vendos përfshirështje të tillë si: për ndryshimin e statutit, zgjelimin e kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitolit themeltar tek të tjerët, zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqerisë apo likujdimi i saj, shndrimi i shoqerisë në shoperi të formave të tjera. Asamblea e zakonshme ose e jashtëzakonshme merr vendime të vlefshme në rast se janë prezant të dy ortakët ose janë të përfaqësuar.

Leku

Muhamet

Neni 11
Administrimi

Shoqeria administrohet nga një administrator i vetëm që duhet të jetë person fizik dhe mund të jetë ortak në shoperi ose jo. Administratori mund të emërohet ose shkarkohet më miratim të dy ortakëve. Emërimi i tij behet prej një kohe prej 2-vjetësh. financiar me përjashtim të rasteve të docëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm. Në marrëheniet me ortakët dhe të tretët administratori ka të gjitha kopetencat për të kryer të gjithë veprimet e administrimit në interes të shoqerisë dhe në emër të saj nepërmjet aktave që janë në përputhje me objektin e shoqerisë, me përjashtim të atyre rasteve dhe kopetencave që ligji dhe ky statut ja jepin shprehimishtë ortakëve. Administratori është përzjegjës ndaj shoqerisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkeljet ligjore, qoftë për shkeljet e statutit ose për faqe të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori ka të drejtë të delegojë një pjesë të kopetencave të tij një ortaku tjeter me qili të një akti me shkrim.

Neni 12
Ekspertët kontabël të autorizuar.

kontrolli i shoqerisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar që është emëruar për 3-vite financiar, me mundesi rizgjedhjeje, me miratim të dy ortakëve. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi në rast se verehen gabime ose behet e paundur kryerja e detyrës.

KREU IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE.

Neni 13
Viti finanziar, llogaritë vjetore.

Qdo vit finanziar fillon me 1 Janar dhe mbalon me 31 Dhjetor. Përjashtimishtë viti i parë finanziar do t'p përfundojë me 31 Dhjetor 1995.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veganta të hartuara nga administratorët dhe eventualishtë nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asamblea dhe me vendim të ortakëve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore behet brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

Neni 14
Dividentët

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve Asamblea e ortakëve përcakton pjesët që u takojnë ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin. Fitmi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcione pjesët e kapitalit themeltar përbëhet nga fitimi i viti financiar të cilit i janë zbritur shumat e lena menjanë përfondin rezervi të domosdoshëm (5% të fitimit të përfunduar deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 të kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivishtë humbjet ose fitimet e mbeturë nga vitet e mëparshme.

KUWU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LTIKUJDTI I SHQBERTSE.

Neni 15

Zgjatja e afatit

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti zgjatja e tij mund të vendoset nga Asamblea me miratim të ortakëve.

Neni 16

Prishja

Shoqeria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve kur behet zgjatja e afatit sipas njësitet 15 ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyen e parashikuarar në ligj. Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakëve falimenton, behet i përafshët ose vdes.

Neni 17
Likujdimi

Shoqeria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së suj. Tër kryerjen e këtij procesi emëron një ose disa likujdatorë Asamblea, Ata paraqesin para "samlesë raportin mbi gjendjen e aktivit dhe të pasivit të shoqerisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit të shoqerisë dhe mbi afatin e nevojshëm të likujdimit të tyre. Në fund të procesit të likujdimit Asamblea vendos me miratim të ortakëve mbi bilancin përfundimtar financier, mbi aktin e rregullshëmrisë së punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. "bas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakëve proporcionalishtë

me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin themeltar.

KREU VI
DISPOZITTA TË FUNDIT

Neni 18

Shdrimi i shoqerisë

Shdrimi i shoqerisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqeri komandite ose kolektive mund të kryhet me miratim të dy ortakëve:

Neni 19

Mosmarrëveshjet


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqerisë ose gjatë periudhës së likujdimit ndërmjet ortakëve do ti paraqiten për zgjidhje gjykatave kopetente shqiptare.

Neni 20

Ky statut është hartuar në katër ekzemplarë në Sarandë, me datën 01/09/1995 në gjuhën shqipe duke pasur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore. Një kopje dorëzohet në Gjykatën e rrethit të Tiranës, kopja tjetër lihet në zyrën notariale, kopja e tretë dorëzohet në degën e tatimeve dhe kopja e katërt mbahet nga vetë ortakët e shoqerisë.

O R T A K E T

JANI TOTO



MIHAL TOTO



REPUBLIKA E SHQIPERISE

HOTERIA

Nr. 1411 Rep.

Nr. 430 Kol.

V E R T E T I M

Sot me datën 01/09/1995, u paraqitet personalishtë para meje në zyrën e notarisë Sarandë shtetasit shqiptarë Jani Toto dhe Mihal Toto, ortek të shoqerisë me përgjegjësi të kufizuar "TOTO-VRION" SH. P. K., me seli në Vrion, madhorë, të aftë dhe me zotësi të plotë juridike përmes vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet e tyre personale, të cilët më deklaruan se sa më sipër është hartuar me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan para meje. Unë notaria Ermioni Gjoka mbasi i gjeta në rregull i vertetoj sipas ligjit.

N O T E R I A



ERMIONI GJOKA